




Raport Studimor


Perceptimet dhe qëndrimet e të
rinjve lidhur me dhunën me bazë
gjinore



Perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve lidhur me dhunën me bazë gjinore

Ky raport është punuar në kuadër të projektit "Policimi në Komunitet si instrument për Shoqërizimin e Ligjit të Rishikuar për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare" zbatuar nga Qendra H.A.N.A, Lezhë dhe mbështetur nga Programi SCPA (Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri) përmes kontributit financiar të Ambasadës Suedeze në Shqipëri.

Mars, 2020



Falenderime

Projekti ka zbatuar me sukses aktivitetet në sajë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të Bashkisë Lezhë (Drejtoria e Shërbimeve Sociale), Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Lezhë, Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, Zyrës Vendore Arsimore Lezhë dhe Bashkisë Mirditë, përfaqësues të të cilëve kanë qenë aktorët kyc të tryezave të ngritura në kuadër të projektit. Falenderimet tona shkojnë gjithashtu për shkollat që janë angazhuar në aktivitetet e organizuara: Shkolla e Mesme e Bashkuar Balldren; Shkolla e Mesme e Bashkuar Zejmen; Shkolla e Mesme e Profesionale 'Kolin Gjoka'; Shkolla e Mesme Shënkoll; Shkolla e Mesme e Bashkuar 'Gjovalin Gjadri'.

Së fundmi, i jemi mirënjohës donatorit që na besoi dhe krijoi mundësinë e ndërhyrjes sonë në komunitet.

Hyrje

Dhuna me bazë gjinore (DhBGj)

është dhunë që i drejtohet një individi bazuar në seksin e tij / saj biologjik ose identitetin gjinor. DhBGj përfshin abuzim fizik, seksual, verbal, emocional dhe psikologjik, kërcënime, shtrëngim dhe privim ekonomik ose arsimor, qoftë në jetën publike apo private.

Dhuna me bazë gjinore është një fenomen i rrënjosur thellë në pabarazinë gjinore dhe vazhdon të jetë një nga shkeljet më të dukshme të të drejtave të njeriut brenda të gjitha shoqërive. Pavarësisht se gratë edhe burrat përjetojnë dhunë me bazë gjinore është pranuar gjerësisht se në masën më të madhe, dhuna me bazë gjinore u shkaktohet grave dhe vajzave, nga burrat. Sidoqoftë, përdorimi i aspektit "të bazuar në gjini" është i rëndësishëm pasi nënvizon faktin se shumë forma të dhunës ndaj grave janë të rrënjosura në pabarazitë e pushtetit midis grave dhe burrave.

Kjo ndasi në pushtet është akoma dhe më e theksuar në shoqërinë tonë patriarkale ku, gratë kanë qenë gjithmonë të nënshtruara dhe të kornizuara kryesisht në rolin e tyre riprodhues sesa atë prodhues dhe krijues në shoqëri. Vitet e fundit, krahas zhvillimit dhe fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave vihet re një rritje e ndjeshme e fenomenit të dhunës në familje, e cila ushtrohet më shumë mbi gratë dhe vajzat, fëmijët dhe të moshuarit. Ky është konkluzioni i raportit të qeverisë shqiptare në Këshillin e Evropës në Strasburg. Sipas Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, rreth një e treta e grave dhe vajzave shqiptare përjetojnë një formë dhune brenda familjes.

Nxitur nga këto të dhëna, por edhe nga ngjarjet e fundit, ku përgjatë dy muajve, Janar-Shkurt 2020, 7 gra kanë humbur jetën për shkak të dhunës në familje, u zhvillua një studim për të matur perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve për këtë fenomen.


Metodologjia e Kërkimit

Raporti Studimor që synon të masë perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve lidhur me dhunën me bazë gjinore është realizuar me popullatën e moshës 14 - 18 vjeçare, në pesë shkolla të mesme në Lezhë, përkatësisht:

- Shkolla e Mesme e Bashkuar “Karl Gega” Balldren
- Shkolla e Mesme e Bashkuar Zejmen
- Shkolla e Mesme e Profesionale “Kolin Gjoka”, Lezhë
- Shkolla e Mesme Shënkoll
- Shkolla e Mesme e Bashkuar “Gjovalin Gjadri”, Gjadër

Metoda e kampionimit të përdorur, për këtë studim sasior, ka qenë kampionim pa probabilitet, konvenient me një numër total prej 118 individësh nga të cilët 87 ishin femra (74 %) dhe 31 meshkuj (26%) dhe instrumenti i përdorur për të mbledhur të dhëna ka qenë pyetësi me pyetje të mbyllura.

Gjetjet





1. Stereotipet Gjinore

Të rinjve iu kërkua të ndërtonin profilin e burrave dhe grave, sipas perceptimit individual, duke u bazuar në një listë me 40 tipare personale, të kategorizuara në

pozitive (*dashuria, mirësjellja, besnikëria, të qenit punëtor, dhembshuria etj.*), **negative** (*homofobia, agresiviteti, egoizmi, arroganca, fanatizmi etj.*) dhe **neutrale** (*mungesa e komplekseve, të qenit i/e fortë, vendosmëria, shkathtësia, sensi i humorit etj.*).

Gratë perceptohen në masë më të madhe si të vendosura (63%) dhe besnike (57%), ndërsa burrat portretizohen kryesisht të shkathtët (51%) dhe fanatik (47%). Karakteristikat e tjera që portretizojnë gratë janë tiparet pozitive si mirësjellja, të qenit punëtorë dhe të





dashura, ndërsa burrat portretizohen nga tipare të përziera: besnik, shakaxhi dhe të vendosur.

Pavarësisht se nuk ka dallime të mëdha biologjike gjinore në performancën konjitive ose tiparet e personalitetit¹, mëyra se si perceptohen dy gjinitë përcaktohet nga normat kulturore dhe sociale të trashëguara ndër breza, të cilat diktojnë sjelljen e individëve në shoqëri. Çfarë bie në sy nga këto gjetje është fakti se si vajzat ashtu dhe djemtë kanë të skematizuara të njëjtat stereotipa gjinore, pothuajse me të njëjtat vlera në përgjigje.

¹ Shih studimet nga Janet Hyde, "Hipoteza e ngjashmërive gjinore." *American Psychology* 60, nr. 6 (2005), 581-592

2. Shembuj të dhunës familjare

Pjesë e pyetjeve në instrumentin e përdorur për këtë studim ishte dhe identifikimi i sjelljeve që konsiderohen dhunë në marrëdhëniet familjare. Pyetja e shtruar ishte: ‘Cila nga sjelljet e mëposhtme është shembull i dhunës familjare?’ dhe pjesëmarrësit ishin të lirë të rrethonin të gjitha alternativat që i mendonin të tilla.

1. Të gënjehet tek miqtë/familjarët e një personi
2. Të ndjekësh këmba këmbës një person
3. Thyerja e gjërave që i përkasin një personi
4. Të përdorësh epitete apo ta tallësh një person
5. Të nënshtrosh një person përpara njerëzve tjerë
7. Ta urdhërosh një person se kë duhet apo nuk duhet të takojë apo ku duhet apo nuk duhet të shkojë
8. Gjuajtja e objekteve ndaj një personi
9. Bullizmi përmes shkrimit (SMS, tekst etj.)
10. Të tradhtosh një person dhe të thyesh besimin e tij/saj
11. Goditja apo grushtimi
12. Kërcënimet
13. Të kërcënosh një person për ta vrrarë atë ose familjen e tij/saj
14. Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë

39 % e djemve & 31% e vajzave të përfshira në studim perceptojnë se **kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë NUK** është formë e dhunës në marrëdhëniet familjare

Sjelljet e shënuara në tabelën e mëposhtme janë sjelljet e identifikuara si dhunë në marrëdhëniet familjare nga më shumë se 58% e pjesëmarrësve.

Cili nga të mëposhtmit mendoni se është shembull i dhunës familjare?	Total	M	F
Goditja apo grushtimi i një personi	58%	58%	59%
Kërcënimet	60%	61%	60%
Të kërcënosh një person për ta vrarë atë ose familjen e tij/saj	62%	58%	63%
Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë	67%	61%	69%

Vihet re se, në tërësi nuk ka dallime gjinore domethënëse përsa i përket mënyrës së perceptimeve të formave të dhunës të paraqitura në tabelë.

Dallimi kryesor midis përgjigjeve të vajzave dhe djemve lidhet me perceptimin e marrëdhënieve seksuale me dhunë si formë e dhunës në familje, ku përqindja e vajzave që e perceptojnë këtë sjellje si të dhunshme është 8% më e lartë krahasuar me djemtë.


Ndërkohë që treguesi shqetësues i këtyre të dhënave lidhet me faktin që një pjesë e të rinjve nuk i konsiderojnë si forma të dhunës në familje, sjelljet më flagrante të këtij fenomeni, përkatësisht:

goditja – 42%,

kërcënimi – 40%,

kërcënimi me jetë – 38 % dhe

kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë – 33%.



Këto përgjigje na bëjnë të kuptojmë se rëndom format tipike të dhunës nuk perceptohen të tilla ose normalizohen për shkak të mënyrës se si shoqëria e trajton fenomenin.

Së pari, kur raportohen akte dhune, deklaratat pothuajse gjithmonë shoqërohen me ‘...sepse’: ‘Një person x u dhuna sepse...’, duke dhënë kështu arsye, të cilat njerëzit i dëgjojnë, i përdorin dhe shpesh i besojnë, duke normalizuar në mënyrë të pandërgjegjshme aktet e dhunës. Rrjedhimisht dëgjojmë shprehje ‘X më ngacmoi sepse...’, ‘X më gjuajti sepse...’, shprehje të cilat tregojnë që dhe personat që përjetojnë forma të dhunës, në mënyrë të pandërgjegjshme gjejnë arsye për të justifikuar dhunën që përjetojnë.


Së dyti, duke qenë një shoqëri kolektiviste, fakti që kultura jonë e vlerëson intimitetin e familjes, duke i dhënë përparësi familjes mbi individin, dukuri që quhet familjarizim (familisim), kontribuon në pranimin e vazhdueshëm të sjelljes abuzive. Është pikërisht familjarizimi që nuk i lejon viktimat e dhunës të kuptojnë situatën në të cilën ndodhen ose që të kërkojnë ndihmë jashtë familjes.

Së treti, mediatizimi, ekspozimi kronik dhe i përsëritur ndaj dhunës në familje, humorit seksist apo reklamave të ndërtuara në bazë të stereotipave gjinore sjell ndryshime në proceset afektive, njohëse dhe të sjelljes. Portretizimet e vazhdueshme të dhunës në media konsiderohet të krijojnë pranimin publik të dhunës² ndërkohë që humori përdoret për të portretizuar seksizmin, zhvlerësimin e grave dhe më e rëndësishmja, dhunën ndaj tyre.

Përgjigja e një gruaje ndaj këtyre shakave është gjithashtu shumë e rëndësishme dhe ka implikime të shumta sociale. Nëse ajo qesh me shakanë, zhvlerëson grupin të cilit i përket e nëse nuk qesh perceptohet si pa sens humori dhe nevrrike, gjithsesi në të dyja situatat ‘fuqia sociale’ e grave është ulur. Për fat të keq në mediat shqiptare vihet re rëndom përdorimi i shakave seksiste, të cilat nuk reflektojnë thjesht supozime themelore për gratë, por gjithashtu krijojnë një atmosferë tolerance për zhvlerësimin e grave.

Përdorimi i reklamave, ku gratë janë duke promovuar detergjentet e gatimit ose duke gatuar në shtëpi dhe burrat duke gatuar në rolet e shëfave të kuzhinës, vazhdon të bëhet duke theksuar stereotipat gjinore. Media ka një rol të padiskutueshëm në informimin, argëtimin dhe edukimin e masave dhe për shkak të faktit që ndikimi i platformave

² Carter C, Weaver C. Violence and the Media. Philadelphia, PA: Open University Press. 2003.



mediatike arrin një numër të madh njerëzish, përgjegjësia e tyre për mesazhet që përcjellin rritet akoma dhe më shumë. Është detyra e tyre si institucione me influencë, që të kalojnë në filtra mesazhet që përcjellin, duke bërë kujdes që mos të rrisin hendekun e diskriminimit dhe pabarazive, qofshin ato gjinore apo sociale.

3. Shkaqet e dhunës

Kur të rinjtë u pyetën se përse njerëzit përdorin dhunë, përdorimi i drogës dhe alkoolit ishte përgjigjja pothuajse unanime (95%), si arsyeja kryesore e përdorimit të dhunës, pasuar nga stresi 74 % dhe vështirësitë ekonomike 70%.

Abuzimi në fëmijëri, vulnerabiliteti fizik e psikologjik dhe dëshira për të kontrolluar, konsiderohen gjithashtu si faktorë që nxisin dhunën.

Pse mendoni se njerëzit përdorin dhunë në një marrëdhënie?	Total	M	F
Alkoolit/drogës	95%	84%	99%
Janë të stresuar	74%	61%	78%
Vështirësive ekonomike	70%	45%	79%
Janë abuzuar kur kanë qenë fëmijë	61%	35%	70%
Vulnerabilitetit fizik apo psikologjik	54%	42%	59%
Duan të kontrollojnë dikë	49%	52%	48%

Ajo që vihet re nga përgjigjet është fakti që, në krahasim me djemtë, përçindja e vajzave që i konsiderojnë këto faktorë si shkak për dhunë në marrëdhëniet familjare është më e lartë duke variuar nga 15-35 % më shumë. Veçanërisht vajzat kanë diferencën më të madhe se djemtë në lidhje me pyetjen që adreson modelimin e sjelljes së dhunshme. Dyfishi i tyre, 35% më shumë, mendojnë se dhuna është sjellje që modelohet në fëmijëri.


Është e rëndësishme të kuptohet që dhunuesit nuk nxiten nga një faktor i izoluar, përkundrazi është një kompleksitet faktorësh që i udhëheqin ata drejt sjelljeve të dhunshme, faktorë që asnjëherë nuk lidhen me viktimat e dhunës, por me mënyrën e reagimit të dhunuesve ndaj situatave të caktuara. Janë katër nivele faktorësh të ndërlidhur më njëri-tjetrin që mund të bëhen shkaktarë të dhunës.

Niveli i parë identifikon **faktorët biologjikë dhe personalë**³ që rrisin rrezikun e përjetimit të dhunës si viktimë ose dhunues. Disa nga këta faktorë janë moshë, arsimit, të ardhurat, përdorimi i substancave ose historia e abuzimit.

Niveli i dytë shqyrton **marrëdhëniet e ngushta** me bashkëmoshatarët, partnerët dhe anëtarët e familjes më të afërt të një personi të cilët ndikojnë dhe kontribuojnë në sjelljen dhe përvojën e tyre.

Niveli i tretë eksploron elementët përbërës të **komunitetit**, siç janë shkollat, vendet e punës dhe lagjet, në të cilat ndodhin dhe zhvillohen marrëdhënie shoqërore.


Niveli i katërt shikon faktorët e gjerë **shoqërorë** që ndihmojnë në krijimin e një klime në të cilën dhuna inkurajohet ose frenohet. Këta faktorë përfshijnë norma sociale dhe kulturore që mbështesin dhunën si një mënyrë të pranueshme për të zgjidhur konfliktet. Faktorë të tjerë të mëdhenj shoqërorë përfshijnë politikën shëndetësore, ekonomike, arsimore dhe sociale që ndihmojnë në ruajtjen e pabarazive ekonomike ose sociale midis grupeve në shoqëri.



Të gjashtë faktorët që kanë theksuar të rinjtë si shkaktarë të dhunës janë faktorë që prekin të katër nivelet e modelit socio-ekologjik që shpjegon këtë fenomen, faktorë të cilët pashmangshmërisht ndikojnë, formojnë ose kufizojnë faktorët në një nivel tjetër.

Gjetje tjetër interesante është diferenca gjinore në perceptimin e të rinjve për të përdorur dhunën si mënyrë për të ushtruar kontroll me dikë. Pavarësisht se ky faktor renditet i fundit

³ <https://www.cdc.gov/violenceprevention/publichealthissue/social-ecologicalmodel.html>



në listë, 14% më shumë e djemve e perceptojnë si mjet për të ushtruar dhe ruajtur kontrollin. Ky faktor lidhet me nivelin e katërt të modelit, duke nxjerrë në pah normat kulturore që legjitimojnë 'të drejtën për të pasur kontroll' nga burrat.

4. Situata të përdorimit të dhunës

Kur të rinjtë u pyetën se në cilat marrëdhënie dhe rrethana është normale dhe e pranueshme që partneri të goditet, pritshmëritë idealiste ishin që përgjigjet të ishin: **në asnjë**, por realiteti ishte ndryshe.

Edhe pse në masë të vogël, të rinjtë e shikojnë dhunën si formë reagimi. Nga përgjigjet vihet re se nuk ka ndonjë lidhje domethënëse mes dhunës dhe llojit të marrëdhënies midis dy personave apo dallime domethënëse gjinore.


A është ok që një grua të:	Total	M	F
a) Të godasë një burrë	11%	13%	10%
b) Të godasë një burrë që është i dashuri i vet	6%	6%	6%
c) Të godasë një burrë që është bashkëshorti i vet	5%	10%	3%
d) Të godasë një burrë në rast se ai s'pushon së debatuari	10%	13%	9%
e) Të godasë një burrë që nuk e trajton atë me respekt	25%	26%	25%
f) Të godasë një burrë nëse ai ka fjetur me dikë tjetër	43%	26%	49%
g) Të godasë një burrë nëse ai e godet i pari	34%	42%	31%

Ajo që bie në sy është justifikimi i dhunës që gratë ushtrojnë ndaj burrave në rast se tregohet mungesë respekti, nëse ka tradhti, ose nëse partneri godet i pari. Pothuajse dyfishi i të rinjve e konsiderojnë të pranueshme ushtrimin e dhunës nga gratë te burrat.

A është OK që një burrë të:	Total	M	F
a) Të godasë një grua	3%	10%	0%
b) Të godasë një grua që është e dashura e vet	3%	10%	1%
c) Të godasë një grua që është gruaja e vet	2%	3%	1%
d) Të godasë një grua në rast se ajo s'pushon së debatuari	6%	16%	2%
e) Të godasë një grua që nuk e trajton atë me respekt	12%	16%	10%
f) Të godasë një grua nëse ajo ka fjetur me dikë tjetër	26%	39%	22%
g) Të godasë një grua nëse ajo e godet e para	17%	39%	9%

Pavarësisht se përqindja e te rinjve që janë pro dhunës për shkak të mënyrës së veshjes është e vogël, ajo që bie në sy është diferenca gjinore në qëndrim, ku djemtë janë pro me 20% më shumë se vajzat. Gjithashtu, flirtimi, si një ndërveprim i vullnetshëm, konsiderohet nga një përqindje e vogël e pjesëmarrësve si arsye për të ushtruar dhunë. Këtu bie në sy fakti se djemtë do të ishin më agresivë se vajzat, me 16% më shumë.


A mendoni se njerëzit meritojnë të dhunohen në një marrëdhënie për shkak të:	Total	M	F
a) Mënyrës si vishen	8%	23%	3%
b) Flirtojnë	14%	26%	10%



Të dhënat e fundit, krijojnë mos përputhje mes perceptimeve, pasi nga njëra anë të rinjtë konsiderojnë si më pranuese që gratë të ushtrojnë dhunë ndaj burrave, nga ana tjetër djemtë pjesëmarrës në studim, konsiderojnë flirtimin apo mënyrën e veshjes si shkak për të dhunuar vajzat.

Nga një shoqëri ku gratë dhe vajzat kanë qenë tërësisht të nënshtruara, qëndrimet e brezave të rinj po ndryshojnë duke konsideruar fuqizim të grave reagimin në formë të dhunshme ndaj situatave të caktuara. Ky është tregues i trashëgimit të një mentaliteti problematik që nuk kontribuon në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme, pasi dhuna nuk justifikohet në asnjë lloj forme dhe rrethane. Fuqizimi i vajzave dhe grave nuk lidhet me ushtrimin e dhunës, por me të punuarin për të parandaluar dhe eliminuar çdo lloj forme të saj.

5. Martesa



Për sa i përket lidhjeve martesore 42% e të rinjve shprehen se martesat më të suksesshme janë martesat që bëhen me dashuri pavarësisht mendimit të tjerëve, duke përfshirë këtu dhe prindërit, pasuar me 29% që konsiderojnë si formë të suksesshme martesën me dashuri, por me aprovim nga prindërit. Pothuaj në të njëjtat rezultate, vetëm me 4% më pak, është dhe përgjigjja që i jep liri vendimmarrje personave që martohen me shkuesi.

Për shumë vite martesë me mblesëri ka qenë normë mbizotëruese në shoqërinë tonë dhe ashtu si ka ndodhur gjerësisht në shoqërinë botërore, martesë ka qenë një institucion i ndërtuar larg lenteve rregullatore të shtetit, si një kontratë e lidhur për të garantuar sigurinë ekonomike të çiftit që martohej. Vendim, që për vajzat dhe gratë merrej nga prindërit, kryesisht nga babai. Martesë ka qenë detyrim për t'u bërë dhe forca për të kundërshtuar ka qenë pothuaj inekzistente.

Në Shqipëri, ky model sjelljeje është thyer, nuk është zhdukur tërësisht, por ashtu si tregojnë dhe të dhënat e këtij pyetësi, perceptimet e të rinjve për suksesin e një marrëdhënie në çift lidhen me respektimin e të drejtës së individit për të zgjedhur atë që çdokush vlerëson si më të mirën për vete. Të rritesh në një mjedis ku vendimi për të zgjedhur partnerin shkon përtej individit, dhe pavarësisht presionit familjar apo shoqëror, të jesh i/e ndërgjegjësuar për të drejtën për të marrë vendime që lidhen me jetën e individit, është tregues pozitiv për ndryshimin e normave patriarkale.

Nga ana tjetër, vihet re që për një pjesë, 29%, mendimi i familjes ka peshë në vendimin që merret. Kjo tregon që marrëdhëniet e të rinjve me familjen bërthamë është e ngushtë dhe pavarësisht fitimit të pavarësisë në të menduar dhe vepruar, individualiteti i anëtarëve të familjes shihet i lidhur ngushtë me sistemin familjar në tërësi.

Cilat martesë mendoni se rezultojnë më të suksesshme për harmoninë në çift?	M	F
a) Me shkes, por çifti është i lirë të vendosë vetë	29%	34%
b) Me shkes, por vendosin prindërit	10%	2%
c) Me dashuri por vetëm me aprovimin e prindërve	39%	39%
d) Me dashuri, pavarësisht mendimit/dakortësimin të tjerëve	48%	59%

Nga përgjigjet e të rinjve shikojmë se vajzat janë më të prirura për marrë vendime të pavarura për jetën e tyre. 11% më shumë vajza do ta merrnin vetë vendimin për tu martuar pavarësisht mendimit të tjerëve dhe 8% më pak do të pranonin të martoheshin duke u bazuar vetëm në vendimin e prindërve. Toleranca e djemve në lidhje me vendimmarrjen e martesës së tyre lidhet me faktin, që gjithsesi ata do të jenë personat në kontroll në marrëdhënien e re të ndërtuar, e drejtë e dhënë apriori nga shoqëria dhe kultura jonë. Rrjedhimisht stresi që vjen me rolet në marrëdhëniet familjare do të jetë më i vogël në krahasim me vajzat, çka i bën ata më të relaksuar dhe tolerantë në situatat kur prindërit marrin vendime për ta.

Rekomandime

- Zhvillimi i programeve lokale për ofrimin e shërbimeve rehabilituese si për dhunuesit ashtu edhe për personat e dhunuar. Shërbimet duhet të përfshijnë këshillim psikologjik, terapi grupi, terapi sjelljeje dhe të jenë të aksesueshme pa pagesë. Kjo gjë kërkon prioritizimin në planet e bashkisë dhe planifikim buxhetor për të krijuar kushtet e përshtatshme për ofrim shërbimesh.
- Ngritjen e një qendre publike komunitare për të ofruar shërbimet e mësipërme është diçka që i nevojitet Lezhës, dhe përveç se do të lehtësonte ofrimin e shërbimeve, mund të shërbejë dhe si qendër emergjence rezidenciale, për rastet me ekstreme që raportohen.
- Fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi në dy nivele, atë mediatik duke përdorur median audiovizive dhe mediat sociale dhe paralelisht fushata ndërgjegjësimi të drejtpërdrejta në shkolla, njësitë administrative apo komunitet. Përveç familjarizimit të ligjit ‘ Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, është i rëndësishëm të vihet theksi te pjesëmarrja e djemve dhe burrave në takime apo aktivitete, pasi interesi i tyre për t’u përfshirë në aktivitete që trajtojnë çështje sociale është më i ulët krahasuar me vajzat dhe gratë.
- Drejtuesit e shkollave, bordi i prindërve, oficeri i sigurisë në shkolla, mësuesit, psikologu/punonjësi social dhe struktura e qeverisë së nxënësve të punojnë së bashku për të hartuar plane vjetore që adresojnë çështjen e dhunës me bazë gjinore duke nxitur pjesëmarrjen aktive të gjitha strukturave të sipërpërmendura. Rol të veçantë do të kishte psikologu me hartimin e planeve konkrete që synojnë edukimin gjinor si të nxënësve ashtu edhe të prindërve.
- Struktura e policimit në komunitet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet lokale: shkolla, njësi administrative, qendra shëndetësore, organizata të shoqërisë civile etj. për të organizuar aktivitete të qëllimta dhe periodike në funksion të rolit që ka.



Rreth Qendrës H.A.N.A

H.A.N.A është një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar ne Mars të vitit 2018, me qendër në Lezhë, qëllimi i të cilës është edukimi i shoqërisë mbi rëndësinë që ka informimi dhe zëri i anëtarëve të saj në çështjet dhe vendimmarrjen publike duke rezultuar kështu në ndërmarrjen e veprimeve konkrete që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin dhe progresin shoqëror. Organizata jonë synon ta arrijë këtë duke krijuar partneritete me struktura publike, të shoqërisë civile, anëtarë komuniteti dhe partnerë ndërkombëtarë si dhe shërbyer si një urë lidhëse mes të trejave.

Web: <https://hanacentre.org/>

Facebook: <https://www.facebook.com/hanacentre.org/>

E-mail: info@hanacentre.org

Youtube: <https://www.youtube.com/channel/UCm3H2y5QppZYjojZaSIZ9Gg>

Adresa: Rr. 'Faik Konica', Ndërtesa Nr.13, Kati II, Shk. I, L. Besëlidhja Lezhë, Shqipëri